



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

RELACION SHPJEGUES

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

***Qëllimi 1** – Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykate, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.*

Ky qëllim është përmbushur në masën 100%.

Në realizimin e plotë të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetësuese për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur tre objektiva për realizim, si më poshtë:

1. **Objektivi 1.1** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja të 30 fëmijëve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020. ***Ky objektivi është përmbushur në masë 87%.***

Për periudhën raportuese, janë parashikuar për t'u realizuar 45 birësime, por mbështetur në numrin e fëmijëve të deklaruar të braktisur si dhe të aplikantëve birësues në listë pritje, është rishikuar numri i pritshëm i birësimeve që do të realizoheshin deri në përfundim të vitit 2020 duke shkuar në 30 birësime. Në fund të vitit 2020, rezultojnë 26 birësime të realizuara, pra kemi një realizim 87% të objektivit. Arsyeja e mosrealizimit të plotë të objektivit është ulja e numrit të dosjeve të fëmijëve të deklaruar të braktisur me vendim gjykate të dorëzuara nga institucionet e përkujdesit social pranë institucionit tonë.

2. **Objektivi 1.2** – Blerje pajisje elektronike. ***Ky objektivi për periudhën Janar-Dhjetor 2020 është përmbushur plotësisht.***

3. **Objektivi 1.3** – Blerje pajisje zyre. **Ky objektiv për periudhën Janar-Dhjetor 2020 është përmbushur plotësisht.**

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objektiv, situata paraqitet si në vijim:

Objektivi 1.1 ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti A – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. **Ky produkt është përmbushur në masën 87%.**

Sasia (sipas planit 12/mujor)	45
Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	30
Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	26

Shpenzimet (sipas planit 12/mujor)	14.500.000 lekë
Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	9.070.000 lekë
Shpenzimet faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	8.855.367 lekë

Kosto/njësi (sipas planit 12/mujor)	322.222 lekë
Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	302.333 lekë
Kosto/njësi faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	340.591 lekë

Shpenzimet për këtë produkt janë përballuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit në fillim të vitit 2020. Këto fonde janë rishikuar gjatë vitit 2020, duke u pakësuar në masën totale prej 5.430.000 lekë. Arsyet e rishikimit të fondeve për shpenzimet korrente janë: struktura e pa plotësuar e institucionit gjatë gjithë vitit, ulja e shpenzimeve për shërbime nga të tretët, si dhe procedurat e prokurimit nuk janë realizuar të gjitha sipas parashikimit në fillim të vitit për shkak të situatës së pandemisë COVID-19. Po ashtu, edhe pagesat për honorare bordi janë realizuar në masë më të vogël se vlera e parashikuar e tyre, gjë që lidhet me prezencën e anëtarëve në mbledhjet e zhvilluar gjatë vitit. **Fondet për këtë produkt janë realizuar në masën 97,6%.**

Objektivi 1.2 ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti A – Pajisje elektronike të blera. **Ky produkt është përmbushur në masën 100%.**

Sasia (sipas planit 12/mujor)	8
Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	5
Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	5

Shpenzimet (sipas planit 12/mujor)	800.000 lekë
------------------------------------	--------------

Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	800.000 lekë
Shpenzimet faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	587.520 lekë
Kosto/njësi (sipas planit 12/mujor)	100.000 lekë
Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	160.000 lekë
Kosto/njësi faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	117.504 lekë

Objektivi 1.3 ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti A – Pajisje zyre të blera. *Ky produkt është përmbushur në masën 100%.*

Sasia (sipas planit 12/mujor)	19
Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	18
Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	18
Shpenzimet (sipas planit 12/mujor)	1.200.000 lekë
Shpenzimet (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	1.200.000 lekë
Shpenzimet faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	668.730 lekë
Kosto/njësi (sipas planit 12/mujor)	63.158 lekë
Kosto/njësi (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	66.667 lekë
Kosto/njësi faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	37.152 lekë

Pasi është bërë detajimi shpenzimeve kapitale për vitin 2020, janë përcaktuar të gjitha pajisjet elektronike dhe të zyrës që nevojiten për zhvillimin normal të punës në institucion si dhe janë kryer procedurat për blerjen e tyre sipas përcaktimeve ligjore. **Fondet për produktin “Pajisje elektronike të blera” janë realizuar 73,4% dhe për produktin “Pajisje zyre të blera” janë realizuar 55,7%.**

Në përfundim të analizës së realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve të programit, mund të themi se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, KSHB ka bërë një punë mjaft të mirë për përmbushjen e politikës së programit të vet. Pavarësisht situatës së pandemisë globale, institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur plotësisht qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, si dhe realizimi i proceseve birësuese brenda dhe jashtë vendit duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijëve.

Gjatë vitit, është bërë vazhdimisht monitorimi i buxhetit të miratuar dhe në çdo rast fondet buxhetore që parashikoheshin të mos realizoheshin deri në përfundim të vitit 2020, janë raportuar si fonde të lira.

Konkretisht, me Aktin Normativ Nr.6, datë 21.03.2020 janë pakësuar 150.000 lekë në llogarinë ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime), me Aktin Normativ Nr.28, datë 02.07.2020 janë pakësuar 1.000.000 lekë nga llogaria ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime), dhe nëpërmjet Aktit Normativ Nr.34, datë 16.12.2020 janë pakësuar 3.390.000 lekë nga llogaria ekonomike 600 (Paga), 650.000 lekë nga llogaria ekonomike 601 (Sigurime shoqërore), si dhe 340.000 lekë nga llogaria ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime), si më poshtë:

- **Artikulli 600** (Pagat)

<i>Buxheti Fillestar</i>	<i>8.500.000 lekë</i>
<i>Fonde të pakësuara gjatë vitit</i>	<i>3.300.000 lekë</i>
<i>Fonde të shtuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<hr/>	
<i>Buxheti i Rishikuar</i>	<i>5.110.000 lekë</i>

- **Artikulli 601** (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore)

<i>Buxheti Fillestar</i>	<i>1.500.000 lekë</i>
<i>Fonde të pakësuara gjatë vitit</i>	<i>650.000 lekë</i>
<i>Fonde të shtuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<hr/>	
<i>Buxheti i Rishikuar</i>	<i>850.000 lekë</i>

- Diferencat shpjegohen me strukturën organike të institucionit të paplotësuar gjatë gjithë vitit buxhetor 2020, ku nga 8 pozicione të miratuara, paraqiten vakant pozicionet:

1. Pozicioni Kryetar, kategori page II-b, periudha e vakancës Janar 2020;
2. Pozicioni Specialist (Shkenca sociale), kategori page IV-a, periudha e vakancës Janar-Dhjetor 2020;
3. Pozicioni Specialist (Psikolog), kategori page IV-a, periudha e vakancës Mars-Dhjetor 2020;
4. Pozicioni Specialist (Jurist), kategori page IV-a, periudha e vakancës Shkurt-Tetor 2020;
5. Një punonjëse e institucionit me kategori page IV-b është larguar me leje barrë lindje gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2020.

- **Artikulli 602** (Mallra dhe shërbime të tjera)

<i>Buxheti Fillestar</i>	<i>4.500.000 lekë</i>
<i>Fonde të pakësuara gjatë vitit</i>	<i>1.490.000 lekë</i>
<i>Fonde të shtuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<hr/>	
<i>Buxheti i Rishikuar</i>	<i>3.010.000 lekë</i>

Diferencat shpjegohen me uljen e shpenzimeve faktike dhe me mos realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik/blerje me vlerë nën 100.000 lekë krahasuar me vlerën e parashikuar të tyre në fillim të vitit, kushtëzuar nga pandemia e COVID-19. Po ashtu, edhe pagesat për pjesëmarrjen në Këshillin Drejtues të KSHB janë më të ulëta se vlera e parashikuar e tyre, gjë që lidhet me pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhjet e zhvilluara.

- **Artikulli 606** (Transferta të brendshme)

<i>Buxheti Fillestar</i>	<i>100.000 lekë</i>
<i>Fonde të pakësuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<i>Fonde të shtuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<hr/>	
<i>Buxheti i Rishikuar</i>	<i>100.000 lekë</i>

Për këtë artikull kontabël janë raportuar 100.000 lekë fonde të lira, të cilat nuk janë rialokuar.

- **Artikulli 231** (Investime)

<i>Buxheti Fillestar</i>	<i>2.000.000 lekë</i>
<i>Fonde të pakësuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<i>Fonde të shtuara gjatë vitit</i>	<i>0 lekë</i>
<hr/>	
<i>Buxheti i Rishikuar</i>	<i>2.000.000 lekë</i>

Për artikullin kontabël 231 (Investime) janë deklaruar 743.750 lekë fonde të lira, të cilat nuk janë pakësuar gjatë rishikimeve buxhetore të vitit 2020.

- **Buxheti Janar-Dhjetor 2020**

Buxheti (sipas planit 12/mujor)	16.600.000 lekë
Buxheti (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	11.070.000 lekë
Realizimi faktik (në fund të 12/mujorit të vitit 2020)	10.111.617 lekë

Në total për vitin 2020, paraqitet një realizim i buxhetit të miratuar prej 91,34%, e cila është tregues mjaft i mirë i planifikimit buxhetor, si dhe i ndjekjes së zbatimit të buxhetit gjatë vitit.

Theksojmë se, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fonde nga Buxheti i Shtetit.

Sa i takon treguesve të performancës, situata paraqitet:

Tregues performance në nivel qëllimi:

1. Përqindja e rasteve të birësimeve të sukseshme ndaj totalit të birësimeve – Parashikimi 100% / Realizimi 100%.

Të gjitha procedurat e birësimit të realizuara brenda dhe jashtë vendit kanë rezultuar të sukseshme dhe përshtatja prind-fëmijë është arritur plotësisht.

Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektiv janë realizuar plotësisht.

Në përfundim, sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar asnjë objekt investimi me financim të huaj. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe si rrjedhojë nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash. Të ardhurat dytësore të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 prej 964.820 lekë janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit.

HARTOI:
SPECIALIST (FINANCE)
Selma Ago

MIRATOI:
KRYETAR
Denada Seferi